



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

PROPOZIM

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA,
NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE, 01. NR. 016-32277 E DT. 19.03.2014

Gjilan, nëntor 2014

Në bazë të nenit 12.2 pika c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008) dhe nenit 39 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe në zbatim të dispozitave të kreut II të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.2008), Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më datën _____, miraton:

Rregulloren
për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa
dhe gjoba komunale, 01. nr. 016-32277 e dt. 19.03.2014

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01. nr. 016-32277 të dt. 19.03.2014.

Neni 2

1. Te neni 4 i rregullores bazë, riformulohen tarifa, paragrafi 2 dhe 3 dhe shtohet një paragrafi i ri si në vijim:

N/r	V e p r i m t a r i t ë / a f a r i s t e	Lartësia e taksës €
2.1	Kompanitë publike regjionale (Hidromorava, Eco-Higjiena)	600.00
2.2	Kompanitë Publike Lokale (Stacioni i Autobusëve)	300.00
2.3	Kompanitë publike nacionale (KEDS, PTK)	1500.00
2.4	Kompanitë publike nacionale (Posta)	750.00
2.5	Kompanitë e sigurimeve – baza	800.00
2.6	Kontrollimet Teknike	500.00
2.7	Bankat ekspoziturat - filialet	800.00
2.8	Institucionet Mikrofinanciare (Kredi-dhënie)	500.00
2.9	Këmbimoret	200.00
2.10	Agjencitë e transferit të parave	150.00
2.11	Marketet prej 100 – 200 m2	100.00
2.12	Marketet prej 200 – 300 m2	200.00
2.13	Marketet mbi 300 m2	300.00
2.14	Super marketet	500.00
2.15	Hipermarketet – mbi 500 m2	1000.00
2.16	Kompanitë e telefonisë mobile, rrjetit të internetit dhe TV kablloviqe (IPKO, Z Mobile, Kujtesa etj.)	1000.00
2.17	Bingot, bastoret, lotaritë dhe lojërat tjera të fatit	1000.00
2.18	Kazino	3000.00
2.19	Restorantet – 200 - 300 metra2	300.00
2.20	Restorantet – mbi 300 metra2	500.00

2.21	Hotelet	500.00
2.22	Motelet	400.00
2.23	Kompanitë e sigurimit fizik të objekteve	300.00
2.24	Pompat e benzinës – baza (në rrugë regjionale)	500.00
2.25	Pompat e benzinës në fshatra	300.00
2.26	Diskotekat	500.00
2.27	Diskobaret	500.00
2.28	Klubet e natës	500.00
2.29	Klinikat mjekësore	300.00
2.30	Ambulancat, laboratorët, rendgenët, stomatologët	200.00
2.31	Autoshkollat	200.00
2.32	Noterët	200.00
2.33	Avokatët	200.00
2.34	Përkthyesit	150.00
2.35	Përmbauesit privatë	150.00

2.	Tarifat dhe ngarkesat prej 2.1 – 2.35 sipas nenit 4.1 të kësaj rregulloreje, mund të paguhet në 2 këste (kësti i parë deri më 30 qershor, kurse kësti i dytë deri më 31 dhjetor të vitit përkatës).
3.	Pikat tjera të shërbimit apo të shitjes të kompanive publike nacionale dhe regjionale në territorin e komunës paguajnë 40% të bazës (pika 2.3 dhe 2.4)
4.	Bizneset nga pika 2.4 deri në 2.25 paguajnë 50% për njësit e tyre dhe pikat e shitjes brenda territorit të komunës.

Neni 3

1. Te neni 5 i rregullores bazë, tarifat 1 deri në 7 largohen për arsye se janë të përcaktuara me udhëzim administrativ nr. 02/2009 PK dt. 21.07.2009.
2. Te neni 5 i rregullores bazë, tarifa nr. 1 ka këtë përmbajtje: “Pranimi i kërkesave 5.00€”.
3. Te tarifa 10 fjala “licencë” zëvendësohet me fjalën “leje”.
4. Pas tarifës 11 shtohet tarifë e re me këtë përmbajtje: “Shfrytëzimi i hapësirës publike për pirje të duhanit (objekt i përkohshëm montues).

– Vlera e tarifës mujore e njëjtë si tarifa nr. 14.

5. Te tarifa nr. 18 shuma e tarifës prej “25,00€” zëvendësohet me tarifën “50.00 €”;
6. Pas tarifës nr. 27, titulli “Leje për bllokim të shiritit rrugor-trotuarit”, tarifa 28 dhe 29 riformulohet dhe ka këtë përmbajtje:

- Leje për bllokim të shiritit rrugor – trotuarit tarifa ditore – 30 €;
- Leje për bllokim të një pjese të trotuarit (hap. Publike) tarifa ditore – 20 €,

7. Titulli pas tarifës 32 “Leje për hyrje ditore në qytet, për një kamion për transportimin e materialit (largimi i dheut, betonit dhe materialit tjetër ndërtimor” tariforet si tarifë ditore 30.00 € kurse tarifa 33.1, 33.2, 33.3 dhe 33.4 fshihen.

8. Tarifa nr. 41 fshihet sepse është e përcaktuar në udhëzimin administrativ MAPL nr. 2000/03 dt. 29.03.2009.

9. Pas tarifës 47 shtohet tarifë e re me këtë përmbajtje:

- **Vendosja e shtyllave elektrike në pronë të komunës 10.00 € për copë.**

10. Tarifa 53 fshihet.

11. Paragrafi 2 i nenit 5 të rregullores bazë ka këtë përmbajtje: “lidhur me kërkesat për shërbime lirohen:

- 2.1.Pala dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushta (babai, nëna, bashkëshorti-ja dhe fëmijët) që marrin ndihmë sociale nga qendra për punë sociale në Gjilan,
- 2.2. Personat me aftësi të kufizuar, familjarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, personat të cilët kanë statusin e invalidit të punës, të luftës dhe personat – shoqatat dhe institucionet qeveritare e jo qeveritare,
- 2.3. Këshillat e fshatrave, të lagjeve dhe të banesave-kërkesat për projekte të infrastrukturës publike,

- 2.4. Kompanitë publike, me rastin e kërimit të lejes për ndërhyrje në infrastrukturë, për mirëmbajtje të rrjeteve të tyre (ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefonik etj.) si dhe kompanitë që i realizojnë e projektet e kontraktuara të komunës;
- 2.5. Organizatat që organizojnë aktivitete për qëllime humanitare dhe
- 2.6. Nxënësit dhe studentet për marrjen e vërtetimeve, referencave e të ngjashme.
12. Lirimi nga tarifat dhe ngarkesat nga paragrafi paraprak të kësaj rregulloreje vërtetohet me dëshmi përkatëse të cilën e ofron kërkuesi i shërbimit.
- 13. Te neni 5 paragrafi 13 riformulohet si në vijim:**
- Të hyrat që realizohen nga zhvendosja e automjeteve 50% shkojnë në emër të komunës së Gjilanit.
 - Pronaret- shfrytëzuesit e mjetit të zhvendosur të cilët vetë e sjellin në autopark me asistim të personave të autorizuar (policit, inspektorit) paguajnë vetëm shpenzimet e vendqëndrimit në autopark në vlerën prej 5,00€
14. Paragrafi 5 dhe 6 i nenit 5 të rregullores bazë fshihet.
15. Te Paragrafi 7 i nenit 5 të rregullores bazë fjala “1-4” fshihet.
16. Paragrafi 8 i nenit 5 të rregullores bazë riformulohet dhe ka këtë përmbajtje:
- “Nga pagesa e tarifës për tërheqje dhe vendqëndrim lirohet pronari i automjetit të vjedhur. Për shpenzimet e vendqëndrimit dhe tërheqjes gjykata duhet ta ngarkoj kryesin e veprës”.
17. Te Paragrafi 9 i nenit 5 të rregullores bazë, titulli riformulohet dhe ka këtë përmbajtje:
- “Nga pagesa e tarifës vjetore komunale lirohen automjetet të cilat përdoren”.
18. Paragrafi 10 i nenit 5 të rregullores bazë fshihet. **(bien ne kundërshtim me ligjin për dhënien e pronës komunale ne shfrytëzim).**

Neni 4

1. Te neni 6 i rregullores bazë pas tarifës 9 shtohet tarifa e re me këtë përmbajtje:
“Kërkesa për Legalizim 100.00€”
2. Te neni 6 i rregullores bazë pas tarifës 10 shtohen tarifat e reja me përmbajtjen si në vijim:

Leja e Ndërtimit për objekte të Infrastrukturës teknike komunale:

1. Shtrirja e rrjetit ajror elektrik, telefonik, telekomunikacionit, TV dhe internetit 0.50/m gjatësi.
2. Shtrirja e rrjetit kabllor nëntokësorë elektrik, energjetik, telefonik, optik, 0.50/ m gjatësi.

**Lejet Mjedisore me listën e aktiviteteve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale
Grupi i parë – 500€**

1. Fabrika për përpunim druri, mobilieri, tapiceri deri 1000m³/vit;
2. Fabrika për ambalazhimin e ujit natyral, mineral; me kapacitet deri në 0.5 m³ në ditë
3. Fabrika për prodhimin e lëngjeve frutash, pije freskuese; pijesh alkoolike me kapacitet deri në .5 m³ në ditë
4. Fabrika për përpunim të qumështit dhe produkteve të tij, deri 1000 kg/ditë
5. Fabrika për përpunim të vajrave bimore, luledielli etj, me kapacitet 500l/ ditë.
6. Prodhimi i gëlqeres (shuarja) deri 100 ton/vit
7. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. Me kapacitet deri në 50 m³ beton/ditë
8. Magazini mi i lubrifikantëve të ambalazhuar në vende prodhim
9. Grumbullimi i mbeturinave të konstruktiv demolim për qëllime të riciklimit përfshirë seleksionimin, copëtimin mekanik dhe deponimin e tyre si dhe caktimin e vendit për deponim
10. Prodhimi i këpucëve dhe aksesorëve të tjerë të ngjashëm, pa procese kimike (qepje, ngjitje montim)
11. Prodhimi i kartonit dhe ambalazheve të tjerë, me kapacitet deri 500 kg/ditë
12. Rritja artificiale e peshkut në hurdhë, me sipërfaqe deri në 300 m²

Grupi dytë -350€

1. Pikëshitjet e gazit (GLN) deri 4.9 m³
2. Furrat për prodhim të bukës dhe produkteve të miellit
3. Thertore me kapacitetet deri 3 gjedhë /ditë
4. Fabrika për përpunim të pemëve dhe perimeve deri në 1000 kg/ditë
5. Punishtet e vogla për përpunim të mermerit, me sipërfaqe totale-objekti deri në 200 m³
6. Ndërtimi i objekteve të banimit dhe shërbimeve, me sipërfaqe ndërtimi më të madhe se 1000m²
7. Magazinat frigorifer, për produktet ushqimore të ambalazuara me kapacitet total magazinues deri në 50 ton.

Grupi i tretë- 300€

1. Sharrimi i lëndës drunore
2. Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndërtimit
3. Impiantet për rritjen intensive të shpezëve, derrave, bagëtive të imta dhe të mëdha që kanë më pak se
 - a. 2000 shpend
 - b. 100 derra
 - c. 30 gjedhë
 - d. 200 bagëti të imëta

Grupi i katërt-200€

1. Autoserviset
2. Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri në 100m³ ose 40 ton gjatë vitit
3. Vendet ku janë të magazinuar, më pas se 10 ton mbeturinë inerte
4. Vendet ku janë të magazinuar, më pak se 2 ton mbeturinë e pa rrezikshme

5. Impiantet për riciklimin dhe prodhimin e masave plastike me kapacitet deri 1000t/vit

Grupi i pestë- 100€

1. Autolarjet
2. Magazinimi i plehrave kimike dhe pesticideve me kapacitet magazinues deri në 10 ton
3. Qebaporet dhe gjellëoret
4. Vendet e tregimit të kafshëve në ambient të hapur (tregjet tradicionale) ose të mbyllura
5. Tregjet urbane, industriale dhe të produkteve bimore dhe shtazore

Grupi i gjashtë- të liruara Projektet Publike

1. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km
2. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitim i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri 5 km.
3. Rikonstruksion i rrugëve urbane dhe rurale ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 2 km)
4. Plantacionet e drurëve frutore
5. Projektet e përmirësimit të pyjeve, pyllëzime, sistemime etj;

Neni 5

Pas miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në rregulloren bazë, teksti i spastruar del me radhitje të re me numra arab sipas neneve të përcaktuara.

Neni 6

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01. nr. _____
Gjilan, më _____ 2014

Kryesuesja e Kuvendit
Valentina Bunjaku Rexhepi

A r s y e t i m i

Projekti i kësaj Rregulloreje është i bazuar në dispozitat e neneve 8, 12 deri në 16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 27 e datës 03.06.2008 si dhe dispozitat e Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014.

Me dispozitat e lartcekura parashihet që Komuna përmes Rregulloreve komunale, për sigurimin e mjeteve vetanake buxhetore, mund të përcaktojë obligime me rastin e zgjidhjes së kërkesave të personave fizik dhe juridik për pagesën e taksave për kryerjen e punëve dhe shërbimeve nga Organet Komunale me të drejtë të rishikimit të tyre.

Me këtë Projekt parashihet ndryshimi dhe plotësimi i rregullores aktuale në dispozitat që prekin shërbimet publike komunale, urbanizmin dhe një pjesë të bizneseve.

Taksat për leje ndërtimore më nuk parashihen të përcaktohen me rregullore, sepse konform nenit 22 të Ligjit nr. 04/L-110 për ndërtim, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18 e datës 03.07.2012, kjo taksë përcaktohet nga Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit. Në projekt rregullore do të përcaktohen taksat për aktivitetet për të cilat kërkohet **Leje Mjedisore**.

Taksa tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore për disa sfera të caktuara si për arsim dhe shëndetësi, kadastër nuk parashihen të përcaktohen me këtë rregullore, sepse ato janë të përcaktuara sipas kompetencës nga Ministritë përkatëse të Qeverisë të Republikës të Kosovës dhe aplikohen nga organet e Komunës në pajtim të udhëzimeve përkatëse administrative.

Lartësia e taksave është përcaktuar në bazë kosto së punës për shërbimet dhe aktivitetet që i ofron Komuna, konform dispozitave të nenit 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.